

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 07/ 2026, 07-01-2026****Parashikimi** nga 07-01-2026, ora 12:00 deri 08-01-2026, ora 23:59.**PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET**

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 07) dhe nesër (e enjte, dt. 08) priten reshje intensive në të gjithë vendin. Në qarqet Shkodër, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshkitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve. Sipas llogaritjeve hidrologjike të IGJEO-s, si rezultat i reshjeve me intensitet të lartë të rëna gjatë ditëve të kaluara, të cilat do të vazhdojnë deri ditën e enjte dt.08 Janar, do të ketë rritje të prurjeve dhe niveleve në lumenjtë Mat, Ishëm, Seman, Shkumbin. Rrezik të shtuar për përmbytje në vazhdim të ditës së sotme dhe të nesërme do të ketë lumi Vjosë, lumi Drin-Buna dhe Liqeni i Shkodrës.

PARASHIKIMI METEO**RESHJET**

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 07) dhe nesër (e enjte, dt. 08) në qarqet Shkodër, Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë priten reshje intensive, ndërsa në qarkun Kukës priten reshje mesatare deri lokalisht intensive. Reshjet priten të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në Veri, Lindje dhe Juglindje në lartësitë mbi 500 m nga niveli i detit reshjet do të jenë në formë dëbore.

TEMPERATURA

Nesër (e enjte, dt. 08) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 5 / 10 °C

në vendet e ulëta: 0 / 9 °C

në vendet malore: -5 / 4 °C

ERA

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 07) dhe nesër (e enjte, dt. 08) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë në bregdet dhe në zonat malore.

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Specialist: Indrit Rexhepi

Koordinator: Elona Abazi (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 07/ 2026, 07-01-2026****Parashikimi** nga 07-01-2026, ora 12:00 deri 08-01-2026, ora 23:59.**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive					
KUKËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	intensive					
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive					
DURRËS	S'KA RREZIK	intensive					
TIRANË	S'KA RREZIK	intensive					
ELBASAN	S'KA RREZIK	intensive					
FIER	S'KA RREZIK	intensive					
BERAT	S'KA RREZIK	intensive					
KORÇË	S'KA RREZIK	intensive					
VLORË	S'KA RREZIK	intensive					
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	mesatare					

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 07 / 2026, 07-01-2026****Parashikimi** nga 07-01-2026, ora 12:00 deri 08-01-2026, ora 23:59.**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**SIMBOLE**

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 07–08.**